

e kanë varrosur Bahriun në fshatin Vataj. Në datën 21. 05.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e fshatit të tij të lindjes së Llaushës/Lauša [Podujevë/Podujevo]. Pas përfundimit të luftës, Qeveria e Përkohshme e Kosovës e ka shpallur Bahriun dëshmor lufte.

Burimet: deklarata F.F, FDH-37111; SHEDUÇK, *Feniksët...* 2, 81-84; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; S. Zhitia, *Deshmoret e UÇK...*, 27, 28.

Murat (Tahir) Berisha

(15.03.1927, shqiptar nga Leshani/Lješane, komuna e Pejës/Peć, murator, pesë fëmijë)

Familja e Muratit, që nga viti 1992, ka qenë shpesh në shënjestër të policisë serbe, kur djali i axhës së Muratit, Tahir Berisha, i kishte vrarë dy policë dhe pastaj policia e vrau edhe atë. Pas kësaj ngjarjeje, policia ka vazhduar të keqtrajtonte familjen Berisha. Në datën **12.05.1998**, nga ora 2:30 pas mesnate, në dhomën në të cilën flinin Murati dhe bashkëshortja Haxhere u hodh një granatë dore [Leshan/Lješane]. Me këtë rast, Murati u plagos rëndë. Ditën tjetër, familjarët e kanë çuar Muratin në spitalin e Pejës/Peć, nga ky e transferuan në spitalin në Prishtinë/Priština, ku ndërroi jetë katër ditë më vonë, më 17.05.1998. Në datën 18.05.1998, bashkëshortja Haxhere e ka marr trupin e Muratit nga morgu i spitalit të Prishtinës/Priština dhe ishte nisur për në Leshan/Lješane, që ta varrose burrin. Por, policia serbe nuk i lejoi Haxheres që të hynte në fshat, kështu që ajo e varrosi Muratin në fshatin Bubavec/Bobovac [Malishevë/Mališevo]. Vetëm më 21.08.1999, ajo i rivarrosi mbetjet mortore të bashkëshortit në fshatin Leshan/Lješane, ku ata edhe jetonin.

Burimi: deklarata H.B, FDH-14027.

Ahmet (Sali) Avdimetaj

(20.09.1935, shqiptar nga Peja/Peć, shtëpiak, i martuar, pa fëmijë)

Ahmeti punonte si shtëpiak në shkollën fillore *Shaban Spahiu* në Pejë/Peć. Në datën 21.05.1998, u nis për një vizitë tek i vëllai në Strelcë të Epërm/Gornji Streoc [Deçan/

Deçani]. E ka marr rrugën nëpër fshatin **Loxhë/Loda**. Atje e ndalën pjesëtarë të policisë serbe. E shkopitën keq Ahmetin dhe një burrë tjetër nga fshati Isniq/Istinić. Ahmetin e liruan vetëm pas tri ditësh, më 24.05.1998, kur ai u kthye në shtëpi. Ishte në gjendje shumë të rëndë. Me autoambulancë e kanë çuar në spital, ku i dhanë ndihmën e parë. Gjatë orëve të mbrëmjes, më **25.05.1998**, Ahmeti ishte alivanosur dhe në mëngjes ka ndërruar jetë nga pasojat e dajakut. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e Pejës/Peć. Bashkëshortja e Ahmetit ka mësuar pas lufte se persona të panjohur e kanë zhvarrosur varrin e Ahmetit në fillim të qershorit të vitit 1999 dhe se e kanë çuar trupin e tij në drejtim të panjohur. Trupi i Ahmetit nuk është zbuluar deri më sot. Rasti i tij është futur në evidencën e KNKK-së për persona të zhdukur dhe lënda e tij e mban numrin BLG-804831-01.

Burimet: deklarata S.A, FDH-37804; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sadri (Metë) Komoni

(14.06.1933, shqiptar nga Peja/Peć, auto-transportues, tre fëmijë)

Sadriu dhe familja e tij kanë jetuar në lagjen *Dardania I/Brežanik I* në **Pejë/Peć**, në Rrugën *Dušan Mugoša* pn. Në mbrëmjen e datës **25.05.1998**, ai ka shkuar te komshiu, Ali Kasumi, për të dëgjuar lajmet. Nga mesnata, ai u nis për në shtëpi. Pasi nuk u kthye tërë natën, familjarët shkuan nesër në mëngjes në polici, por atje nuk kishin njohuri për të. Po atë ditë, familjarët kanë mësuar se trupi i pajetë i Sadriut gjendet në morgun e spitalit të Pejës/Peć. E kanë varrosur në varrezat e qytetit. Më vonë, një komshi u ka treguar familjarëve që në natën mes 25 dhe 26.05.1998, ai kishte parë nga ballkoni i vet kur një burrë, i cili ka dal nga vetura e ngjyrës së kuqe, e ka ndaluar Sadriun. Ky burrë fliste serbisht. E pyeti Sadriun si quhet dhe kur ky iu përgjigj, ai qëllloi mbi të me armë zjarri.

Burimet: deklarata G.K, FDH-14768; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 178, FDH-23816; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vre-*